



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1137 Prot.

Tiranë, më 02.07.2025

URDHËR

Nr. 87, datë 02/07/2025

MBI

**“MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË
PËRBASHKËT NR. 157, DATË 03.06.2025 “PËR MIRATIMIN E KALENDARIT
PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026”,
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit Nr. 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025 - 2026, me përbërje si më poshtë:
 - Dorian Çene
 - Suela Kromidha
 - Edlira Isak
2. Konkursët e pranimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të ofruara nga fakultetet e UART do të zhvillohen **në datat 20 deri më 22 Gusht 2025**.
3. Administruesi i UART, për sistemin e **Portalit U – Albania** Përgjegjësi i Sektorit të IT të marri masa që **në datat 05 - 06 Gusht 2025**, të shkarkojë nga Portali U – Albania listën e kandidatëve që do të konkurrojnë në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të ofruara nga UART, të publikojë në faqen zyrtare të UART, sipas përcaktimeve ligjore si dhe ti dërgohen Sekretarive mësimore të fakulteteve në UART dhe Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.

4. Sektori Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, **brenda datës 07 Gusht 2025**, të afishojë në mjediset e fakulteteve listën e kandidatëve për konkurset e pranimi 2025 - 2026.
5. Regjistrimi i kandidatëve për konkurset e pranimi në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, do të bëhet pranë sekretarive mësimore të fakulteteve, **në datat 11 deri më 19 gusht, nga ora 08:00 deri në orën 16:00**.
6. Dokumentacioni për t'u regjistruar në konkurset e pranimi është:
 - Mandati i pagesës së tarifës së konkurimit;
 - Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës.
7. Regjistrimi pranë sekretarive mësimore të fakulteteve të UART, bëhet nga vetë konkurenti ose nga një person i autorizuar prej tij/saj, me prokurë të posaçme.
8. Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurset e pranimi të ciklit të parë Bachelor, vetëm kandidatët sipas listës së shkarkuar nga portali U-Albania.
9. Të afishohen në mjediset e secilit nga fakultetet të UART, Urdhrat/Vendimet mbi masat e marra për konkurset e pranimi të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor, rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimi, rregulloret dhe kriteret e transferimit të programit të studimit ose të konkurrimit në një program të dytë studimi, si dhe çdo procedurë tjetër të nevojshme për këtë proces.
10. Strukturat përgjegjëse të secilit fakultet të marrin masat e nevojshme për zhvillimin e konkurseve të pranimi si dhe ndjekjen me përgjegjësi të afateve të përcaktuara sipas etapave të zhvillimit të konkurseve dhe procedurave të regjistrimit të kandidatëve/studentëve.
11. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit anëtarët e grupit të monitorimit, Dekanët e fakulteteve të UART, Administratori i UART, Përgjegjësit e Njësive Bazë, sekretarët mësimore të fakulteteve, dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.
12. Të njoftohet për marrjen e masave të veçanta për administrimin dhe ruajtjen e ambienteve të UART, për periudhën e konkurseve, shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike ILLYRIAN GUARD.

Ky urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve.

